

TERMAT E REFERENCËS PËR FINACIM PUBLIK TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Kriteret e përgjithshme të thirrjes publike për projekt propozime

Dispozitat e rregullores kanë paraparë një numër të kushteve të përgjithshme të cilat duhet t'i plotësoj secila OJQ aplikuese. Përmes vendosjes së këtyre kushteve të përgjithshme aplikohen standardet minimale formale të cilat, kërkohen nga Organizatat Jo-Qeveritare të cilat synojnë implementimin e projekteve ose programeve përmes mbështetjes financiare publike.

Kriteret dhe procedurat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të janë:

1. OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit;
2. Të jetë e pajisur me Numër Fiskal - të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ- duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal;
3. OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoj në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme;
4. OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmangë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta;
5. Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit. Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.

Komisioni Vlerësues i Ofruesit të mbështetjes financiare varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes publike përmbushjen e kriterëve formale do të bëjë një vlerësim formal të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. Përmbushja e kriterëve formale nënkupton dorëzimin brenda afatit të thirrjes të një aplikimi me projekt-propozim, së bashku me dokumentet e kërkuara përmes thirrjes.

Në momentin e aplikimit për financim publik të projekt-propozimeve, Organizatat joqeveritare duhet të dorëzojnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative);
2. Certifikatën e numrit fiskal (Obligative);
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative);
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative);
5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (obligative);
6. Një deklaratë me shkrim që nuk ka/ si dhe nuk do të pranoj mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
8. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme;
9. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
10. Të dërgojë dëshmi të implementimit të projekteve/programeve të ngjashme (të ofrojë dëshmi se ka përmbushë së paku një projekt nga natyra e ngjashme. Të dëshmohet me reference pozitive - kopje).

Procesi i vlerësimit procedural dhe përmbajtjesor të aplikimit është shpjeguar më tej në dokumentin e udhëzimeve të thirrjes, shih formularin Formularin F4.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në kuadër të financimit publik të projekteve nga kategoria e subvencioneve, do të mbështes këto fusha: (1) Aktiviteteve promovuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; (2) Aktiviteteve promovuese në fushën e energjisë, (3) Financimi i projekteve/ programeve të OJQ-ve në aktivitetet

promovuese në fushën e ekonomisë, si dhe (4) Financimi i aktiviteteve vetëdijesuese dhe promovuese të fushës së edukimit në energji.

(1) Financimi i Aktiviteteve promovuese në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin e zhvillimit të TIK-ut në Kosovë dhe në promovimin e eksportit të shërbimeve në fushën e TIK.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

1. Promovimi i zhvillimit të TIK-ut në Kosovë
2. Promovimi i rritjes së eksportit të shërbimeve në fushën e TIK-ut

3. Organizatat jo- qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e zhvillimit të TIK-ut në Kosovë dhe në promovimin e eksportit të shërbimeve në fushën e TIK përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ Organizim i ngjarjeve B2B nëpërmjet investitorëve dhe ndërmarrësve në nivel shtetëror
- ✓ Organizim i konferencave/punëtorive ndërkombëtare që kanë për qëllim promovimin e TIK-ut të Kosovës, që trajtojnë tema të rëndësishme të përparimeve në tregun global të TIK-ut në botë, për shërbimet e reja mobile 5G dhe alokimit të spektrit frekuencor në dritën e shfrytëzimit të dividendës digjitale, për pjesëmarrjen e grave në punët online, etj;
- ✓ Përfaqësimit/prezantimit të industrisë së TIK-ut të Kosovës në tregun ndërkombëtar (panaire ndërkombëtare të TIK).

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 10.000,00 €. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1.000,00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5.000,00 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është {15 ditë} pune dhe përfundon me datën 07.09.2018.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti {dy (2) projekte} në kuadër të kësaj thirrje, por mund të përfitojnë vetëm {një (1) projekt} për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

7. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *{një vit}* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e *{Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit}*. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

8. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

9. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik*, si ofrues i mbështetjes financiare (web faqja: <http://mzhe-ks.net/>).

10. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *{Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sheshi "Nëna Terezë" Nr. 36, 10 000, Prishtinë}*.

11. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

12. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

13. Kriteret specifike në bazë të të cilave do të vlerësohen projektet janë:

- (a) Sa i rëndësishëm është projekti/oferta dhe ndërhyrjet e propozuara karshi prioritetëve sektoriale të Ministrisë? (Rëndësia)
- (b) Kualiteti i projektit/ofertës së dorëzuar dhe sa arrijnë objektivat të përcaktuara në ofertë qëllimin përfundimtar? (Kualiteti/objektivat)

- (c) Deri në çfarë mase është projekti/oferta e qëndrueshme dhe arrin parimin e kosto-efektivitetit? (Qëndrueshmëria)
- (d) Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave të programit apo projektit të propozuar me objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes;
- (e) Kapacitetet e aplikuesit për realizimin e projektit apo programit konform objektivave të përcaktuara dhe synimeve të thirrjes, duke përfshirë edhe përvojën dhe ekspertizën e personelit të propozuar;
- (f) Vlerësimin e përvojës së aplikuesit në zbatimin e programeve apo projekteve të njëjta ose të ngjashme;
- (g) Qëndrueshmëria e programit.

14. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: fmzhe.tik@rks-gov.net

(2) Financimi i projekteve/ programeve të OJQ-ve ne aktivitetet promovuese në fushën e energjisë (efiçencën e energjisë, burimet e ripërtërishme dhe mbrojtje të mjedisit nga zhvillimi i aktiviteteve energjetike)

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka për qëllim krijimin e kushteve për furnizim të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji, për të krijuar kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues duke promovuar shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimin, mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet e energjisë dhe veprimet me të cilat krijohen dhe në bazë të të cilave zbatohet politika e energjisë dhe planifikimi i zhvillimit të sektorit të energjisë.
2. Në lidhje me realizimin e qëllimit në fushën e energjisë, MZHE do të mbështet Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) të cilat në kuadër të profilit të tyre kanë fushat e lartcekura me qëllim të rritjes së kontributit të tyre në proceset që lidhen me përgjegjësit e DE/MZHE, përkatësisht në kontributin e tyre në ngjarje promovuese siç janë: organizime, konferenca, diskutime, punëtori, manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Rëndësia e mbështetjes së OJQ, qëndron në faktin se përmes tij synohet ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të rritjes së kontributit në promovimin e EE, BRE dhe mjedisit tek konsumatorët dhe opinionin e gjerë publik lidhur me rëndësinë që paraqesin EE, BRE dhe mjedisi për zhvillimin e një koncepti të qëndrueshëm të sigurisë së furnizimit me energji, plotësimin e kërkesës për energji, rritjen e kualitetit të furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.
4. Projekti lidhur me mbështetjen financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ne aktivitetet promovuese në fushën e energjisë, trajton tri komponentë: eficiency e energjisë (EE), burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE) dhe mbrojtje të mjedisit nga këndvështrimi i sektorit të energjisë.
5. Organizatat jo- qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e eficiency së energjisë (EE), burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE) dhe mbrojtje të mjedisit nga këndvështrimi i sektorit të energjisë si më poshtë:
 - ✓ Ngjarje promovuese, organizime, konferenca, diskutime, punëtori,

- manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me eficiencën e energjisë;
- ✓ Ngjarje promovuese, organizime, konferenca, diskutime, punëtori, manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE); dhe
 - ✓ Ngjarjet promovuese, organizime, konferenca, diskutime, punëtori, manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur mbrojtje të mjedisit nga këndvështrimi i sektorit të energjisë.
6. Projekti zhvillohet gjatë vitit (2018). Zbatimi i tij fillon pas nënshkrimit të kontratës, sipas planit dinamik të dorëzuar nga OJQ te Kontraktori, e të miratuar nga Kontraktori.
 7. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 10.000,00 €. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1.000,00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5.000,00 €.
 8. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është {15 ditë} punë dhe përfundon me datën 07.09.2018.
 9. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti {dy (2) projekte} në kuadër të kësaj thirrje, por mund të përfitojnë vetëm {një (1) projekt} për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
 10. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku {një vit} para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e {energjisë}. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
 11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe

prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si ofruet i mbështetjes financiare* (web faqja: <http://mzhe-ks.net/>).
13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: {*Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sheshi "Nëna Terezë" Nr. 36, 10 000, Prishtinë*}.
14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.
15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
16. Kriteret specifike në bazë të të cilave do të vlerësohen projektet janë:
 - (a) Sa i rëndësishëm është projekti/oferta dhe ndërhyrjet e propozuara karshi prioritetëve sektoriale të Ministrisë? (Rëndësia)
 - (b) Kualiteti i projektit/ofertës së dorëzuar dhe sa arrijnë objektivat të përcaktuara në ofertë qëllimin përfundimtar? (Kualiteti/objektivat)
 - (c) Deri në çfarë mase është projekti/oferta e qëndrueshme dhe arrin parimin e kosto-efektivitetit? (Qëndrueshmëria)
 - (d) Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave të programit apo projektit të propozuar me objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes;
 - (e) Kapacitetet e aplikuesit për realizimin e projektit apo programit konform objektivave të përcaktuara dhe synimeve të thirrjes, duke përfshirë edhe përvojën dhe ekspertizën e personelit të propozuar;
 - (f) Vlerësimin e përvojës së aplikuesit në zbatimin e programeve apo projekteve të njëjta ose të ngjashme;
 - (g) Qëndrueshmëria e programit.
 - (h) Posedimi i kontratave valide me ekspertë me përvojë në aspektin promovues që lidhen me efikasitet të energjisë, burime të ripërtëritshme dhe mjedis;
 - (i) Të ketë zhvilluar projekte me karakter promovues në fushën e energjisë dhe të posedoj dëshmi mbi punët e realizuara;

(j) Të prezantoj anëtarët (listën) e stafit që do të marrin pjesë në këtë projekt duke përfshirë: liderin e ekipit të projektit, inxhinierët e fushës dhe stafin relevant;

17. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: rina.lluka@rks-gov.net

(3) Financimi i aktiviteteve vetëdijesuese dhe promovuese të fushës së inxhinierisë elektrike

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e energjisë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin dhe ngritjen e vetëdijes për studime në fushën e energjisë.
2. Në lidhje me realizimin e qëllimit në fushën e energjisë, MZHE do të mbështet Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) të cilat në kuadër të profilit të tyre kanë informimin, promovimin dhe ngritjen e vetëdijes për specializimin në fushën e energjisë, përmes: organizimeve, konferencave, diskutimeve, punëtorive, manifestimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, programeve për financim të aktiviteteve studimore në fushën e inxhinierisë elektrike, etj.
3. Rëndësia e mbështetjes së OJQ-ve në këtë fushë, qëndron në faktin se Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në kuadër të Universitetit të Prishtinës, ka trend rënës në absorbimin e studentëve në fushën e energjisë në përgjithësi. Marrë për bazë trendet në ekonominë globale dhe vendore, veçanërisht projektet kapitale në fushën e energjisë me potencial të lartë për krijim të vendeve të punës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik është e përkushtuar në sensibilizimin e gjeneratave të reja për specializim në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë.
4. Projekti zhvillohet gjatë vitit (2018). Zbatimi i tij fillon pas nënshkrimit të kontratës, sipas planit dinamik të dorëzuar nga OJQ te Kontraktori, e të miratuar nga Kontraktori.
5. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 15.000,00 €. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1.000,00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5.000,00 €.
6. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është {15 ditë} pune dhe përfundon me datën 07.09.2018.
7. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti {dy (2) projekte} në kuadër të kësaj thirrje, por mund të përfitojnë vetëm {një (1) projekt} për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

8. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku *{një vit}* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e edukimit *{energjisë}*. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

9. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

10. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si ofrues i mbështetjes financiare* (web faqja: <http://mzhe-ks.net/>).

11. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *{Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sheshi "Nëna Terezë" Nr. 36, 10 000, Prishtinë}*.

12. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

13. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

14. Kriteret specifike në bazë të të cilave do të vlerësohen projektet janë:

- (a) Sa i rëndësishëm është projekti/oferta dhe ndërhyrjet e propozuara karshi prioritetëve sektoriale të Ministrisë? (Rëndësia)
- (b) Kualiteti i projektit/ofertës së dorëzuar dhe sa arrijnë objektivat të përcaktuara në ofertë qëllimin përfundimtar? (Kualiteti/objektivat)
- (c) Deri në çfarë mase është projekti/oferta e qëndrueshme dhe arrin parimin e kosto-efektivitetit? (Qëndrueshmëria)
- (d) Vlerësimi i përputhshmërisë së objektiveve të programit apo projektit të propozuar me objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes;

- (e) Kapacitetet e aplikuesit për realizimin e projektit apo programit konform objektivave të përcaktuara dhe synimeve të thirrjes, duke përfshirë edhe përvojën dhe ekspertizën e personelit të propozuar;
- (f) Vlerësimin e përvojës së aplikuesit në zbatimin e programeve apo projekteve të njëjta ose të ngjashme;
- (g) Qëndrueshmëria e programit;
- (h) Posedimi i kontratave valide me ekspertë me eksperiencë në aspektin promovues që lidhen me efikasitet të energjisë, burime të ripërtëritshme dhe mjedis;
- (i) Të ketë zhvilluar projekte me karakter promovues në fushën e energjisë dhe të posedoj dëshmi mbi punët e realizuara;
- (j) Të prezantoj anëtarët (listën) e stafit që do të marrin pjesë në këtë projekt duke përfshirë: liderin e ekipit të projektit, inxhinierët e fushës dhe stafin relevant;

15. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: frina.lluka@rks-gov.net

(4) Financimi i projekteve/ programeve të OJQ-ve në aktivitetet promovuese në fushën e ekonomisë

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka për qëllim krijimin e kushteve për sektorin privat me qëllim të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit, përmes investimeve vendore dhe të huaja.
2. Në lidhje me realizimin e këtij qëllimi, MZHE do të mbështet Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) të cilat në kuadër të profilit të tyre kanë zhvillimin e sektorit privat dhe fuqizimin e ekonomisë së tregut. Si model mund të jenë asociacionet e biznesit të cilat kanë synim zhvillimin e sektorit privat dhe komunitetit të biznesit në përgjithësi.
3. Rëndësia e mbështetjes së OJQ në këtë fushë, qëndron në faktin se përmes këtij financimi synohet ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të rritjes së kontributit në promovimin dhe zhvillimin e sektorit privat, veçanërisht sektorit prodhues dhe eksportues të produkteve apo shërbimeve jashtë vendit.
4. Projekti lidhur me mbështetjen financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në aktivitetet promovuese apo përkrahëse fokusohet në: përkrahjen e komunitetit të biznesit me theks në prodhim apo ofrim të shërbimeve me origjinë nga Kosova, si dhe eksportin e produkteve apo shërbimeve vendore jashtë vendit.
5. Organizatat jo- qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në arritjen e këtyre qëllimeve përmes:
 - ✓ Ngjarje promovuese, panairë, organizime, konferenca, diskutime, punëtori, manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me produktet apo shërbimet vendore;
 - ✓ Misione tregtare jashtë vendit me synim të afirmimit të brendit “Made in Kosova”;
 - ✓ Sponsorizim të pjesëmarrjes dhe materialeve promovuese (marketing) në lidhje me produktet apo shërbimet vendore në aktivitetet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit;

6. Projekti zhvillohet gjatë vitit (2018). Zbatimi i tij fillon pas nënshkrimit të kontratës, sipas planit dinamik të dorëzuar nga OJQ te Kontraktori, e të miratuar nga Kontraktori.
7. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 10.000,00 €. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1.000,00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5.000,00 €.
8. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është {15 ditë} pune dhe përfundon me datën 07.09.2018.
9. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti {dy (2) projekte} në kuadër të kësaj thirrje, por mund të përfitojnë vetëm {një (1) projekt} për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
10. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku {një vit} para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e {prodhim dhe ofrim të produkteve/ shërbimeve vendore, si dhe eksport}. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, si ofrues i mbështetjes financiare (web faqja: <http://mzhe-ks.net/>).

13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: {Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sheshi "Nëna Terezë" Nr. 36, 10 000, Prishtinë}.
14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.
15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
16. Kriteret specifike në bazë të të cilave do të vlerësohen projektet janë:
- (a) Sa i rëndësishëm është projekti/oferta dhe ndërhyrjet e propozuara karshi prioriteteve sektoriale të Ministrisë? (Rëndësia)
 - (b) Kualiteti i projektit/ofertës së dorëzuar dhe sa arrijnë objektivat të përcaktuara në ofertë qëllimin përfundimtar? (Kualiteti/objektivat)
 - (k) Deri në çfarë mase është projekti/oferta e qëndrueshme dhe arrin parimin e kosto-efektivitetit? (Qëndrueshmëria)
 - (l) Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave të programit apo projektit të propozuar me objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes;
 - (m) Kapacitetet e aplikuesit për realizimin e projektit apo programit konform objektivave të përcaktuara dhe synimeve të thirrjes, duke përfshirë edhe përvojën dhe ekspertizën e personelit të propozuar;
 - (n) Vlerësimin e përvojës së aplikuesit në zbatimin e programeve apo projekteve të njëjta ose të ngjashme;
 - (o) Qëndrueshmëria e programit.
17. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: rrona.zhuri@rks-gov.net }